

VENDIM
Nr. 739, datë 9.9.2015

**PËR DISA SHITESA NË RREGULLOREN E ZBATIMIT TË KODIT RRUGOR TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 153, DATË 7.4.2000,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ë”, të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

1. Pas nenit 20 shtohet neni 20/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 20/1

Sistemi i të dhënave të aksidenteve rrugore (neni 11 i Kodit Rrugor)

1. Sistemi i të dhënave të aksidenteve rrugore (SDA) shërben për mbledhjen, për përpunimin, për ruajtjen, për shpërndarjen dhe për përdorimin e të dhënave të aksidenteve rrugore në të gjithë rrjetin rrugor shqiptar, si pjesë integrale e sistemit të menaxhimit të sigurisë rrugore.

2. Ky sistem është ndërtuar mbi bazën e një programi kompjuterik *Microsoft Office Acces* dhe shoqërohet nga manuali i përdorimit (manuali për futjen e të dhënave dhe manuali për analizën e të dhënave), që i bashkëlidhet rregullores.

3. Mbledhja e të dhënave bëhet nga shërbimet e policisë rrugore që operojnë në vendngjarje, duke plotësuar formularin e miratuar të aksidentit (Shtojca 1. Raporti i aksidentit rrugor). Pasi kontrollohen, të dhënat e hedhura i dërgohen Drejtorisë së Policisë Rrugore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në formë elektronike, brenda ditës, ndërsa raportet e aksidenteve të muajit dërgohen brenda datës 5 të muajit pasardhës.

4. Drejtoria e Policisë Rrugore, pasi kontrollon të dhënat e administruara zyrtarisht me ato të dërguara në rrugë elektronike gjatë muajit, duke rakorduar me të dhënat e urgjencave shëndetësore të Spitalit të Traumës, Tiranë, të emergjencave civile, të mjekësisë ligjore, enteve pronare të rrugës dhe autoritetit të sigurimeve, ia dërgon ato, në rrugë elektronike, brenda datës 10 të muajit pasardhës, Drejtorisë së Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore, në ministrinë përgjegjëse për transportin.

5. Drejtoria e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore, mbështetur në programin SDA, përpunon të dhënat e marra nga Policia Rrugore dhe bën analizën e shkaqeve të ndodhjes së aksidenteve rrugore, me qëllim që ato të përdoren:

- nga policia rrugore, për ndërmarrjen e veprimeve për përmirësimin e sigurisë rrugore në ato vende ku kanë ndodhur aksidente rrugore;

- nga vetë Drejtoria e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore, për përcaktimin e pikave të zeza dhe krijimin e hartës digjitale;

- nga autoritetet përgjegjëse të rrugëve, për marrjen e masave në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, kur kjo dëmtohet, si dhe në përmirësimin e pikave të zeza;

- nga organizma të tjerë, të përfshirë në sigurinë rrugore, për hartimin e planeve të veprimit dhe për zbatimin e tyre, me qëllim përmirësimin e situatës.”.

2. Në fund të rregullores shtohet manuali i përdorimit (manuali për futjen e të dhënave dhe manuali për analizën e të dhënave), që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

¹ Ky vendim synon përputhjen e plotë të vendimit të Këshillit të Bashkimit Evropian, nr. 93/704/EC, datë 30 nëntor 1993, “Mbi krijimin e një baze të dhënash të komunitetit mbi aksidentet rrugore”, dokumentit 31993D0704; OJ No L 329/63.

BAZA E TË DHËNAVE TË AKSIDENTEVE RRUGORE

Manual për futjen e të dhënave

1. Parathënie

Të pasurit në dispozicion i të dhënave të aksidenteve rrugore, është një domosdoshmëri për çdo sistem të menaxhimit të sigurisë rrugore. Të dhënat e azhurnuara të aksidenteve janë të nevojshme për identifikimin e problemeve të sigurisë rrugore dhe për ngritjen e informacionit publik. Të dhënat e aksidenteve janë një element vendimtar për çdo ndërhyrje të sigurisë rrugore, me qëllim parandalimin e aksidenteve rrugore.

Por nuk janë vetëm përshkrimi i rrethanave të aksidentit të nevojshme. Ndihma e faktorëve të tillë, si karakteristikat e rrugës dhe të trafikut, parametrat e mjeteve lëvizëse, informimi për personat e përfshirë në aksident, duhet të jenë të regjistruara po aq mirë.

Sistemi i të dhënave të aksidenteve (SDA) zbatohet për të gjithë rrjetin rrugor shqiptar.

Programi bazohet në kompetencën e policisë rrugore, për të kryer një hetim të aksidentit, si dhe një raport mbi rrethanat e aksidentit. Të dhënat e hedhura përpunohen dhe analizohen, me qëllim që:

- të përdoren nga vetë policia për plane strategjike në marrjen e veprimeve për të përmirësuar sigurinë rrugore;

- të përdoren nga organizma të tjerë përgjegjës për sigurinë rrugore për hartimin dhe zbatimin e strategjive gjithëpërfshirëse;

- të përdoret nga entet pronare të rrugëve; si dhe

- nga institucione të tjera të përfshira në sigurinë rrugore.

Mbledhja e të dhënave bëhet nga njësitë rajonale të policisë rrugore që operojnë në vendndodhje, duke plotësuar raportin e aksidentit rrugor.

Për të bërë një analizë efektive, për të nxjerrë konkluzione sa më të sakta, nga të dhënat është e nevojshme që të plotësohen këto kërkesa thelbësore:

- saktësia (për të përshkruar saktësisht parametrat e veçantë);

- kompleksiteti (për të përfshirë të gjitha veçoritë brenda sistemit të dhënë);

- disponueshmëria (që të jenë të disponueshme nga të gjithë përdoruesit);

- njëtrajtshmëria (për t'u përdorur përcaktime standarde).

Parametri i fundit (njëtrajtshmëria) është i një rëndësie të veçantë për krahasimet. Edhe në nivel kombëtar është e rëndësishme që edhe përcaktimet lokale të përputhen me ato kombëtare.

Shumë studime të sigurisë rrugore janë të drejtuara në përmirësimin e cilësisë së parametrave të rrugëve. Problemi më i madh kur drejton këto studime është përcaktimi i vendndodhjes së saktë të aksidentit. Si pasojë, disponueshmëria e një metode lokalizimi, është një element kryesor për çdo sistem informimi rrugor. Pa një njohuri të besueshme të vendndodhjes së aksidentit dhe pa të dhëna të përshtatshme, mundësitë për të zgjidhur të metat lokale janë të limituara.

Një pikë rreziku (*black spot*) është një term që përdoret në menaxhimin e sigurisë rrugore për të përcaktuar një vend ku aksidentet janë të përqendruara. Pa një lokalizim të saktë të aksidenteve rrugore, specialistët e sigurisë rrugore, nuk janë në gjendje të gjejnë dhe të trajtojnë me efektivitet pikat e rrezikut në rrjetin e tyre të rrugëve. “Lokalizime të pasakta” do të thotë identifikime të gabuara dhe humbje në kohë dhe në anën financiare.

2. Përkufizime

“Ngjarje rrugore”, ngjarje që ndodh në një rrugë publike ose në një rrugë private në të cilën publiku ka të drejtën e aksesit. Përfshin të paktën një automjet në lëvizje me të paktën një person të plagosur apo të vranë, si dhe ato vetëm me dëme materiale, të raportuar nga shërbimet e policisë rrugore.

“Ngjarje rrugore vetëm me dëme materiale”, ngjarje që ndodh në një rrugë publike ose në një rrugë private në të cilën publiku ka të drejtën e aksesit. Përfshin të paktën një automjet në lëvizje, vetëm me dëme materiale, të raportuar nga shërbimet e policisë rrugore.

“Aksident rrugor”, ngjarje që ndodh në një rrugë publike ose në një rrugë private në të cilën publiku ka të drejtën e aksesit. Përfshin të paktën një automjet në lëvizje me të paktën një person të plagosur apo të vranë, të raportuar nga shërbimet e policisë rrugore.

“Personi i vranë në 30 ditë”, vdekja brenda 30 ditëve, si pasojë e një aksidenti rrugor.

“Aksident fatal”, aksidenti me të paktën një person të vranë ndërmjet personave të tjerë të përfshirë, pavarësisht nga serioziteti i plagosjes.

“Aksident me plagosje”, aksidenti me të paktën një person të plagosur ndërmjet personave të

përfshirë, pa specifikimin e llojit të plagosjes.

“Aksident me plagosje të rënda”, aksidenti që ka sjellë si pasojë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim tjetër të përhershëm të shëndetit, ndërprerjen e shtatzënisë ose ka qenë i rrezikshëm për jetën në çastin e shkaktimit të tij.

“Aksident me plagosje të lehta”, aksidenti që ka shkaktuar te personat e përfshirë, paaftësi të përkohshme më tepër se 9 (nëntë) ditë.

“I panjohur”, aksidenti për të cilin nuk raportohet serioziteti i plagosjes në mesin e personave të përfshirë.

“Përplasje këndore”, përplasje ndërmjet automjeteve që lëvizin. Automjeti i parë ka një pikë përplasjeje anësore, automjetet e tjera kanë një pikë përplasjeje ballore.

“Përplasje zinxhir”, përplasje ndërmjet më shumë se dy automjeteve që lëvizin. Automjeti i parë ka një pikë përplasjeje të pasme, automjeti tjetër ka një pikë përplasjeje ballore, e kështu me radhë dhe për automjetet e tjera që vijnë pas.

“Përplasje me kafshë”, përplasje ndërmjet automjeteve dhe kafshëve.

“Përplasje me pengesën”, përplasje ndërmjet automjetit në lëvizje dhe pengesës, në ose jashtë rrugës. Pengesë fikse ose në lëvizje. Përfshin pemë, postera, barrierat e sigurisë etj.

“Përplasje me makinë të parkuar”, përplasje ndërmjet mjetit që lëviz dhe automjetit të parkuar.

“Përplasje me këmbësorin”, përplasje ndërmjet automjetit që është duke lëvizur dhe këmbësorëve.

“Përplasje ballore”, përplasje ndërmjet dy automjeteve që udhëtojnë në drejtim të kundërt në të njëjtën rrugë. Të dyja automjetet kanë një pikë përplasjeje ballore.

“Përplasje anësore” përfshin përplasje këndore, përplasje krah për krah. Automjeti i parë ka një pikë përplasjeje anësore, automjetet e tjera kanë një pikë frontale ose përplasjeje anësore.

“Aksident i një automjeti të vetëm, kur nuk ka pengesa”, aksidenti në të cilin është përfshirë vetëm një automjet. Përfshin automjetin e dalë nga rruga.

“Përplasje krah për krah”, përplasje ndërmjet dy automjeteve, ku të dyja automjetet kanë një pikë përplasjeje anësore.

“Përplasje e pasme”, përplasje ndërmjet dy automjeteve që udhëtojnë në të njëjtin drejtim, në të njëjtën rrugë. Automjeti i parë ka një pikë të pasme përplasjeje, automjeti tjetër ka një pikë ballore përplasjeje.


“Pikë rreziku” është vendi ku në një segment rruge me rreze 300 m, kanë ndodhur të paktën dy aksidente me pasojë vdekjen apo plagosje të rënda, brenda një periudhe 3-vjeçare.

3. Hyrje

Baza e të dhënave të aksidenteve rrugore, në bazë të raportit të aksidentit rrugor, përmban informacion për 32 të dhëna të ndryshme që kërkohet të plotësohen për një aksident rrugor, përkatësisht:

- | | | |
|---------------------------------------|-------------------------------|--------------------------|
| - Viti | - Muaji | - Ditë jave |
| - Ora | - Rrethi | - Qarku |
| - Rruga | - Serioziteti | - Tipi i aksidentit |
| - Rrethinat | - Tipi i sipërfaqes | - Gjeometria e rrugës |
| - Kushtet e rrugës | - Moti | - Kushtet e ndriçimit |
| - Faktorë të tjerë | - Lloji i automjetit | - Defektet e automjetit |
| - Limiti i shpejtësisë së lejuar | - Mosha e automjetit | - Sjellja e drejtuesit |
| - Kërkesat e automjeteve | - Leja e drejtimit | - Eksperienca në drejtim |
| - Kombësia e drejtuesit të automjetit | - Testi i alkoolit | - Sjellja e këmbësorëve |
| - Kategoria e përdoruesve të rrugës | - Gjinia | - Grup-mosha |
| - Tipi i plagosjes/dëmtimit | - Përdorimi i rripit/helmetës | |

Komponentët kryesorë të bazës së të dhënave janë:



Të dhënat e pamanipuluara mbahen të ndara në dosjen *albaniadata.mdb*, në fund, ndërkohë që, moduli i futjes së të dhënave *albaniaentry.mdb* dhe moduli i analizimit *albaniaanalysis.mdb* në fillim, shkruajnë dhe lexojnë të dhënat nëpërmjet lidhjeve që krijohen nga sistemi.

Të gjitha dosjet ruhen në direktorinë *c:\road_safety_database*.

Baza e të dhënave përbëhet nga 12 tabela kryesore ku mbahen të dhënat e mëposhtme:

- | | |
|--|---------------------------------------|
| - të dhëna të përgjithshme të aksidentit | - lloji i automjetit |
| - defektet e automjetit | - nevojat e automjetit |
| - mosha e automjetit | - dëshmia e drejtuesit të automjetit |
| - eksperiencia në drejtim | - kombësia e drejtuesit të automjetit |
| - sjellja e drejtuesit të automjetit | - testi i alkoolit |
| - sjellja e këmbësorëve | - përfshirja në aksident |

Tabelat kanë një kolonë të përbashkët, *Nr. i aksidentit*, e cila është kolona kryesore që bashkon të dhënat e të gjithë bazës së të dhënave. Përveç kësaj, ka edhe shumë tabela të tjera ndihmëse me tituj për kodet e ndryshme që përdoren.

4. Kërkesat e sistemit, instalimi dhe vënia në punë:

- sistemi kërkon një kompjuter me të paktën 128 MB memorie të RAM-it;
- kompjuteri duhet të ketë të paktën 500 MB zonë të lirë në njësinë qendrore të njësise C:\;
- kompjuter me sistem operimi *Windows XP/98/2000/NT*;
- kompjuter me paketë *Office 2003 Professional* që përmban modulet *MS Access*, *MS Excel*, *MS Query*, *MS Word* dhe njësi (database) *ODBC*;
- menutë janë projektuar për rezolucion ekrani nga 600 deri në 800 pixels.

Shënim 1. Nëse paketa *MS Office Professional* nuk është instaluar siç përshkruhet më sipër, aplikimi i analizimit nuk do të funksionojë!

Shënim 2. Për të shmangur paralajmërimet e sigurisë në *Access 2003*, veprohet si më poshtë: Nga menuja kryesore në *MS Access*, shkohet në *Tools_Macro_Security* ku përzgjidhet opsioni *Low*.

Ky opsion lejon përdorimin e makrove dhe kodit *Visual Basic* pa paraqitur në ekran paralajmërimin normal.



Aplikimi është zhvilluar në *MS Access 2003* që përdor *MS Excel*, *MS Query* dhe *MS Word* për prezantimin e të dhënave.

Instalimi bëhet nëpërmjet programit *Setup* që jepet në CD. Gjithashtu, mund të bëhet edhe mekanikisht duke kopjuar dosjet *albaniaentry.mdb*, *albaniaanalysis.mdb* dhe *albaniaentry.mdb* nga CD-ja në direktorinë *c:\road_safety_database*.

Kini parasysh që, nëse dëshironi të punoni direkt në *MS Access*, duke anashkaluar aplikimin, kjo është e mundur nëse veprohet si vijon: Duke përdorur *Windows Explorer*, klikoni dy herë mbi dosjen *albaniaentry.mdb* duke mbajtur të shtypur tastin *Shift*. Baza e të dhënave do të hapet në model *MS Access*. Për të filluar aplikimin që këtu, hapni formën *FWelcome*.

Për të filluar aplikimin normalisht, klikohet mbi ikonën e instaluar në desktop (ekranin e kompjuterit). Aplikimi mund të fillohet edhe nga klikimi dy herë mbi dosjen *albaniaentry.mdb* që gjendet në direktorinë *c:\road_safety_database*.

Shënim 3. Aplikimi është i lidhur me të dhënat e dosjes *albaniaentry.mdb* në direktorinë *c:\road_safety_database*. Kjo bëhet automatikisht nga aplikimi dhe në qoftë se lidhjet humbasin rastësisht ato mund të rikthehen duke përdorur *Link Table Manager in MS Access (Tools Database Utilities Linked Table Manager)*

5. Menuja kryesore

Pas ekranit mirëseardhës shfaqet menuja kryesore që jepet më poshtë:

Te Dhenat Baze Te Aksidentit Rrugor - [Faccident Data Menu : Form]

File Edit Insert Records Window Help Type a question for help

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Te Dhenat Baze Te Aksidentit Rrugor

Fusni te Dhenat	Permbajtja E Te Dhenave Baze Te Pergjithshme Te Aksidentit 6 Perfshirja e Mjeteve 12 Difektet e Mjetit 13 Moshja e Mjetit 12 Kërkesat e automjeteve 30 Sjellja e Shoferit 18 Licensa e Shoferit 15 Kombësia e Shoferit 14 Eksperienca në Drejtim 13 Testi i Alkohoolit 12 Sjellja e Këmbësorëve 5 Përfshirë në Aksident 14	Asnje E Dhene Ndryshimi i Numrit te Aksidenteve Mbeshtetja e te Dhenave Miratimi I Pjeses Importoni Te Dhenat Eksportoni Te Dhenat Shihni Rrjetin E Rrugeve Lokale
------------------------	---	---

Dalja

Menuja paraqet disa opsione në butonat e komandave në të majtë dhe të djathtë dhe, gjithashtu, tregon edhe numrin e aksidenteve të regjistruar në tabelën e të dhënave.

5.1 Futja e të dhënave në sistem

Për pasqyrimin e informacionit të raportit të aksidentit rrugor në tabelën e të dhënave duhet të plotësohen katër tabela të ndryshme. Tabela e parë mbulon informacionin e përgjithshëm të aksidenteve dhe ka formën e mëposhtme:

Te Dhenat Baze Te Aksidentit Rrugor 1. Te Dhenat Te Pergjithshme Te Aksidentit

Hiqje perseri ju lutem

Aksidenti Nr TR/02/127/2005 tr/02/127/2005 Data 26/04/2005 Ora 15:30 Rreth 32 Tirana

Vendndodhja: Rruga Margarita Tutelani Rruga Nr 999 GPS x-koord. 7756777 y-koord. 783456 I Panjohur

Tipi i aksidentit

☐ Aut/Aut kokë me kokë
☐ Aut/Aut nga prapa
☐ Aut/Aut nga anash
☐ Aut/Aut në parakalim
☐ Aut/Aut në kthesë
☐ Aut, i përmbysur
☐ Aut veçuar, rrëzuar ne "ujë"
☐ Aut i veçuar, i përplosur
☐ Aut/me këmbësor
☐ Aut/me ciklist
☐ Aut/me kafshë
☐ Aut/me të tjerë
☐ Biciklete / këmbësor
☐ Të tjera, të pa përcaktuar

Tirane

Natyrë e Aksidentit

☐ Fatal ☒ Plagosje Serioze ☐ Plagosje e Minore

Gjeometria e Rruges

☐ -- Rrugë e drejtë
☐ C-Kthesë
☐ O-Rreth
☒ T-Kryqëzim
☐ Y-Kryqëzim
☐ + Kryqëzim
☐ X-Kryqëzim
☐ II Urë
☐ =Kryqëz Rrug/Hekurudh
☐ Tunnel

Tipi i Sipërfaqes

☒ Prej bitumi
☐ Me zhavorr
☐ Tokë

Limbi i Shpejtësisë i shënuar

☐ Kufiri i Shpejtësisë i shënuar
☒ Kufiri i Shpejtësisë i pashënuar

Kufiri i Shpejtësisë i shënuar km/orë 0

Kushtet e Rrugëve

☒ E Mirë/premtuese
☐ Me gropa
☐ Me valëzime
☐ E Rrëshqitshme
☐ Me Pluhur

Kushtet e Ndricimit

☒ Ditë
☐ Natë
☐ Agim/Muzg

Faktorë të tjerë

☐ Automjetet i vjedhur
☐ Godet dhe ikën
☐ Punime në rrugë

Rrethinat

☐ Zonë Rurale
☒ Zonë Urbane
☐ Shesh

Moti

☒ I thatë
☐ Me shi / i lagësht
☐ Me borë / ngrica
☐ Me mjegull

Vazhdoni me të Dhenat e Mjeteve

Dalja

Secila fushë ka vlera të paracaktuara karakteresh për të shmangur futjen e të dhënave të pasakta. Për plotësimin e tabelës ndiqen rregullat dhe formatet e dhëna më poshtë:

Numri i aksidentit. Kjo e dhënë e detyrueshme përdoret për të identifikuar çdo aksident. Format i përdorur është QARKU/KK/NNN/VVVV ku QARKU shërben për shënimin e shkurtimit të Qarkut,

si p.sh., TR, VL, SH etj. (shih shtojcën 2 për shkurtime të përdorura). KK-ja shërben për shënimin e kodeve të komisariteve në qarqe. Kështu, EL03 është kodi për Komisaratin e tretë në Elbasan i cili është në Gramsh. NNN është numri rendor i aksidentit gjatë vitit, duke filluar nga numri 1. Në tabelën e dhënë më sipër është regjistruar aksidenti i 127-të në Komisaratin nr. 2 në Tiranë (në 2005). VVVV-ja shërben për shënimin e vitit, 2005 e kështu me radhë. Kini parasysh që edhe vizat ndarëse “/”, janë pjesë e numrit të identifikimit të aksidentit.

Për shkak të rëndësisë së numrit të aksidentit si fushë kryesore, në bazën e të dhënave, operatorit që merret me futjen e të dhënave i kërkohet që numrin e aksidentit ta regjistrojë dy herë për qëllime krahasimi.

Duhet të kihet parasysh që numri i aksidentit përdoret edhe për të identifikuar raportet e policisë për analizimin e pikave të zeza të aksidenteve ose për studime më të thella për aksidentet. Prandaj, dosja e policisë duhet të ketë një referencë të numrit të aksidentit për të garantuar identifikimin.

Data. Shënimi i datës është, gjithashtu, i detyrueshëm dhe duhet të jepet në formatin që vijon DD/MM/VVVV, p.sh. 02/03/2005.

Koha. Ora e ndodhjes së aksidentit shënohet në formatin që vijon OO:MM, p.sh. 08:30.

Rrethi. Edhe kjo është një fushë e detyrueshme, d.m.th. programi nuk përparon nëse lihet një fushë bosh. Në fushë shënohet kodi për rrethin përkatës nga 1–36. kodet e rretheve gjenden në shtojcën 2.

Vendndodhja, rruga dhe koordinatat GPS. Këto fusha përdoren për identifikimin e vendndodhjes së aksidentit. Për sa i përket rrugës, mund të shënohet numri i rrugës nacionale ose kodi për një rrugë lokale. Kur klikohet në “?” hapet pasqyra e rrugëve ku gjenden edhe kodet përkatëse. Për secilin rreth do të jepet një tabelë (e printuar) e rrjetit rrugor lokal. Kjo arrihet nga dosja *Excel, local road network.xls* që ruhet në *c:\road_safety_database*, por duhet të kihet parasysh që kodet për rrugët lokale nuk kanë ende një përcaktim zyrtar. Prandaj, kodet përdoren vetëm për tabelën e të dhënave. Për të nxjerrë kodin e seksionit duhet të konsultohet harta e rrethit përkatës.

Për rrugët ndërlidhëse dhe ato të qyteteve të cilat nuk mund të identifikohen përdoret kodi 999, “I Panjohur”.

Megjithatë, për identifikimin e aksidentit duhet të përdoren koordinatat GPS. Në të ardhmen sistemi SIA do të përmirësohet për të pasur edhe funksionin e GIS-së.

Natyra e Aksidentit. Edhe kjo është një fushë e detyrueshme e cila duhet të plotësohet. Klasifikimi varet nga natyra e dëmtimit që kanë pësuar personat e aksidentuar. Në rast vdekjeje, sigurisht që aksidenti është fatal. Nëse personi i aksidentuar ka pësuar dëmtime të lehta atëherë kemi aksident me pasojë plagosje etj.

Për udhëzimet në lidhje me plotësimin e fushave duhet të konsultohet dokumenti i veçantë për përdorimin e kodeve.

Në fund të dritares dialoguese gjenden dy opsione, *Vazhdoni me të dhënat e automjetit* ose *Dalja*.

Kur vazhdohet me të dhënat e automjetit shfaqet një dritare dialoguese me mesazhin që në disa fusha mungon informacioni, për shembull:



Më pas operatori ka mundësinë e pasqyrimit të të dhënave që ishin harruar.

Tabela e dytë për futjen e të dhënave mbulon informacionin rreth automjeteve të përfshira në aksident:

Microsoft Access - [FVehicle Data : Form]

File Edit View Insert Format Records Tools Window Help Type a question for help

Aksidenti Nr **Te Dhenat Baze Te Aksidentit Rrugor**

TR/01/34/2005

2. Te Dhenat e Mjetit

Licensa e Shoferit	1	2	3	4
Shofer nxënës	☐	☐	☐	☐
Mbajtës	☒	☒	☐	☐
Jo-mbajtës	☐	☐	☐	☐

Eksperiensa/drejtimit	1	2	3	4
Nën 3 vjetë	☒	☐	☐	☐
3-6 vjetë	☐	☐	☐	☐
6-9 vjetë	☐	☐	☐	☐
Mbi 9 vjetë	☐	☒	☐	☐

Kombësia e shoferit	1	2	3	4
Qytetar Shqiptar	☒	☒	☐	☐
I huaj	☐	☐	☐	☐

Mosha e automjetit	1	2	3	4
0-2 vjetë	☒	☒	☐	☐
2-7 vjetë	☐	☐	☐	☐
7-12 vjetë	☐	☐	☐	☐

Perfshirja E Mjeteve	1	2	3	4
Makinë, autoveturë	☒	☒	☐	☐
Mikrobuz, 8+1	☐	☐	☐	☐
Minibuz, > 8+1	☐	☐	☐	☐
Autobuz	☐	☐	☐	☐
Kamioninë < 3.5t	☐	☐	☐	☐
Automjete sportive	☐	☐	☐	☐
Kamion i rëndë > 3.5t	☐	☐	☐	☐
Kamion i rëndë trailer	☐	☐	☐	☐
Motorçiklete	☐	☐	☐	☐
Karrocë me kafshë	☐	☐	☐	☐
Biçikletë	☐	☐	☐	☐
Traktor ferme	☐	☐	☐	☐
Të tjera	☐	☐	☐	☐

Difektet E Mjetit	1	2	3	4
I panjohur	☐	☒	☐	☐
Timoni, boshti frontal	☐	☐	☐	☐
Frenat	☐	☐	☐	☐
Rrotat, gomrat	☐	☐	☐	☐
Xhami mbrojtës	☐	☐	☐	☐
Vështirësi pamjeje	☒	☐	☐	☐
Mbingarkesë	☐	☐	☐	☐
Të tjera	☐	☐	☐	☐

Nevojat E Mjetit	1	2	3	4
Të regjistruara	☒	☒	☐	☐
Të parregjistruara	☐	☐	☐	☐
Të kolauduara	☒	☐	☐	☐
Të pa kolauduara	☐	☒	☐	☐
Të siguruara	☒	☒	☐	☐
Të pa siguruara	☐	☐	☐	☐

Mire Fshirja e te Dhenave te Hyrjes

Vetem Nje Cast Kontrolllo Kutine E Pershtatshme Dhe Pastaj Kliko Mire

Form View

Për secilën të dhënë klikohet kutia përkatëse. Numri i automjetit, p.sh. 1, duhet t'i korrespondojë të njëjtit automjet për të gjitha ndryshoret.

Kur klikohet mbi butonin *Mirë* kalohet te tabela *Sjellja*, d.m.th., të dhënat për drejtuesit e automjeteve, këmbësorët dhe testin e alkoolit.

Microsoft Access - [Te Dhenat Aksidenti, Ponañanje]

File Edit View Insert Format Records Tools Window Help Type a question for help

Te Dhenat Baze Te Aksidentit Rrugor 3. Te Dhenat Aksidenti, Sjellja

Aksidenti Nr TR/01/34/2005

Sjellja e Shoferit	1	2	3	4
Asgjë e dukshme	☒	☐	☐	☐
Nuk ka ndaluar dritës së kuqe STOP	☐	☐	☐	☐
Nuk jep rrugë	☐	☐	☐	☐
Injoron shenjat e trafikut	☐	☐	☐	☐
Parakalim i pakujdesshëm	☐	☐	☐	☐
Afrim i pakujdesshëm (përballë)	☐	☐	☐	☐
Kthesë e pakujdesshme, prerje	☐	☐	☐	☐
Ndryshim i papritur i drejtimit	☐	☐	☐	☐
Rikthim me neglizhencë	☐	☐	☐	☐
Frenim i papritur	☐	☐	☐	☐
Ecje pranë rrotave të tjetrit, të qendrosur aty	☐	☐	☐	☐
Ndalim jo korrekt/parkim	☐	☐	☐	☐
Shpejtësi shumë e lartë	☐	☒	☐	☐
Verbuar nga dielli/automjet vjen përballë	☐	☐	☐	☐
Te mos qendrosur ne korsine p	☐	☐	☐	☐
I lodhur, i fjetur, i sëmurë	☐	☐	☐	☐
Tjetër	☐	☐	☐	☐

Testi i alkoolit	1	2	3	4
Jo alkool	☒	☒	☐	☐
Alkool mbi kufijtë ligjore	☐	☐	☐	☐
Pa test	☐	☐	☐	☐

Sjellja e Këmbësorëve	1	2	3	4
Asgjë e dukshme	☐	☐	☐	☐
Kalim muge po kujdes	☐	☐	☐	☐
Kalim këmbësorësh	☐	☐	☐	☐
Kalim rrugë diku tjetër	☐	☐	☐	☐
Duke ecur nëpër rrugë	☐	☐	☐	☐
Të tjera	☐	☐	☐	☐

Mire Fshirja e te Dhenave te Hyrjes

Vetem Nje Cast Kontrolllo Kutine E Pershtatshme Dhe Pastaj Kliko Mire

Form View

Si me tabelën e mëparshme, numri i drejtuesit të automjetit duhet t'i korrespondojë numrit të

automjetit, d.m.th., automjeti nr. 1 ➔ drejtuesi i automjetit 1 etj. Nëse në aksident është përfshirë edhe ndonjë këmbësor, kutia përkatëse do të shënohet për kujtesë me të kuqe.

Tabela e katërt dhe e fundit për futjen e të dhënave mbulon personat e përfshirë në aksident:

The screenshot shows a web form titled "Te Dhenat Baze Te Aksidentit Rugor". At the top, "Aksidenti Nr:" is filled with "TR/01/34/2005". Below it, "Person nr:" is filled with "1". A yellow box highlights the text "4. I Përfshirë në Aksident". The form contains several sections with radio buttons: "Kategoria e Përdoruesit të rrugës" with "Shofer" selected; "Gjinia" with "Mashkull" selected; "Moshë" with "1" entered; "Plagosje" with "Vrës" selected; and "Usage Rrip/Helmet" with "Po" selected. There are also checkboxes for "Pasager", "Këmbësor", "Çiklist", "Motorçiklist", and "Te tjerë". At the bottom, there are two buttons: "Ruaj" (green) and "Dalja" (blue). Below the buttons, a counter shows "0 Fakte(t) Ruhen Tek Te Dhenat Baze".

Si vlerë bazë, sistemi jep *Personi nr. = 1, Mjeti = 1, Kategoria = Shofer, Gjinia = Mashkull*. Në varësi të kodit për "Serioziteti", sistemi do të plotësojë "Lloji i plagosjes". Për pasojë, operatori që fut të dhënat do t'i pranojë këto vlera automatike ose do ta korrigjojë informacionin. Pastaj duhet të jepet moshë dhe përdorimi i rripit/helmetës.

Kur mbarohet me këtë hap, mund të klikohet mbi butonin *Ruaj* për të ruajtur të dhënat dhe për të vazhduar me personin e dytë. Teksti nën butonin *Ruaj* do të tregojë që *1 fakte(t) ruhen te të dhënat bazë*.

This screenshot shows the same form as the previous one, but for "Person nr. 2". The "Aksidenti Nr." remains "TR/01/34/2005". The "Person nr." is now "2". The "Mjetit:" field is filled with "2". The "Gjinia" is "Mashkull", "Moshë" is "1", "Plagosje" is "Vrës", and "Usage Rrip/Helmet" is "Po". The counter at the bottom now shows "1 Fakte(t) Ruhen Tek Te Dhenat Baze", with a red arrow pointing to the number "1".

Kur është futur informacioni për të gjithë personat, atëherë klikohet butoni *Dalja*. Pas kësaj del një tabelë konfirmuese e cila paraqet të gjithë informacionin e futur:

Microsoft Access - [FAccidentDataConfirm : Form]

Tahoma 9 B I U

File Edit View Insert Format Records Tools Window Help Type a question for help

Te Dhenat Baze Te Aksidentit Rrugor

Rreth Tirana Xcoord 0 Ycoord 0

Aksidenti Nr TR/01/34/2005 Data 12/01/2005 Ora 11:00 Natyra e Aksidentit Fatal Moti

Vendndodhja Rrrr Rruga Nr 999 Tipi i aksidentit Aut/me qiklist Limiti i Shpejtësisë Po 0

Gjeometria e Rruges X-Kryqëzim Tipi i Sipërfaqes Prej bitumi Rrethinat Zonë Urbane

Kushtet e Rrugëve e Mirë/premtuese Faktorë të tjerë Kushtet e Ndricimi Ditë

Automj. të përfsh.ve **Defekt.e Automjeteve** **Kërkesat e automjeteve** **Mosha e automjetit**

Mjetit 1	Mjetit 2	Mjetit 1	Mjetit 2	Mjetit 1	Mjetit 2	Mjetit 1	Mjetit 2
Makinë, autovet	Makinë, autovet	Vështirësi pamje	I panjohur	Të rregjistruara	Të kolauduara	0-2 vjetë	0-2 vjetë

Licensa e Shoferit **Eksperi. në drejtim** **Kombësia e shoferit** **Testi i alkoolit**

Shofer 1	Shofer 2	Shofer 1	Shofer 2	Shofer 1	Shofer 2	Shofer 1	Shofer 2
Mbajtës	Mbajtës	Nën 3 vjetë	Mbi 9 vjetë	Qytetar Shqiptar	Qytetar Shqiptar	Jo alkool	Jo alkool

Sjellja e shoferit **Sjellja e Këmbësorë**

Shofer 1: Asgjë e dukshme

Shofer 2: Shpejtësi shumë e lartë

Këmbësorëve:

I Përfshirë në Aksident

Kategoria e Përdoruesit	Nr.Mjetit	Gjinia	Mosha	Tipi I Plagosjes	Rripi/Helmet	
Person 1	Shofer	1	Femra	34	Vrërë	Përdorimi/Jo
Person 2	Çiklist	2	Meshkuj	34	Jo Plagosje	Përdorimi/Jo
Person 3						
Person 4						

Mire, Ruaj Dhenat Base

Korrigjoni Gabimet

Anulim

Form View

Shënim. Në këtë fazë, i gjithë informacioni i futur ruhet në tabelat e përkohshme, i cili nuk është regjistruar në bazën e të dhënave. Kështu që, gabimet e mundshme mund të korrigjohen duke klikuar mbi butonin *Korrigjoni gabimet*.

Nga pasqyra e mëposhtme mund të përzgjidhet informacioni që duhet të korrigjohet:

Te Dhenat Baze Te Aksidentit Rrugor **Te Dhena Te Pergjithshme Te Aksidentit Redaktimi**

Aksidenti Nr TR/01/34/2005

Alternativat:

- ☒ Te Dhena Te Pergjithshme Te Aksidentit
- ☐ Sjellja e Shoferit
- ☐ Testi i alkoolit
- ☐ Përfshirja E Mjete
- ☐ Defektet E Mjetit
- ☐ Kombësia e shoferit
- ☐ I Përfshirë në Aksident
- ☐ Nevojat E Mjetit
- ☐ Mosha E Mjetit
- ☐ Eksperienca në drejtim
- ☐ Sjellja e Këmbësorëve

Redaktimi, Fshirja, Mbledhja Te Dhenat?

☒ Redaktimi I Te Dhenave

☐ Fshirja I Te Dhenave

☐ Mbledhja Te Dhenat

Selekto tipin e te dhenave qe ju doni te shfaqni

Anulim/
Rikthimi Ne Trajten e Meparshmer.

Operatori duhet të tregojë, gjithashtu, nëse ai kërkon të redaktojë, korrigjojë të dhënat ose të fshijë informacionin e tepërt.

Në këtë shembull duhet të korrigjohen *Të dhënat bazë të aksidentit rrugor*.

Te Dhenat Baze Te Aksidentit Rrugor		Redaktimi	
Aksidenti Nr	TR/01/34/2005	Prethinat	2 Zonë Urbane
Natyra e Aksidenti	1 Fatal	Tipi i Sipërfaqes	1 Prej bitumi
Data	12/01/2005	Kushtet e Rrugëve	1 e Mirë/premtuese
Ora	11:00	Moti	0 I panjohur
Rreth	32 Tirana	Faktore të tjerë	0 I panjohur
Vendndodhja:	Rrrr	Kushtet e Ndërcimit	1 Ditë
Rruga Nr	999	Limiti i Shpejtësisë i shënuar	1 Po
X-coord	0	Kufiri i Shpejtës. i shënuar km/orë	0
Y-coord	0		
type i aksidentit	10 Aut/me siklist		
Gjeometria e Rruges	7 X-Kryqëzim		

Ju lutem beni ndryshimet dhe pastaj dhe kliko mire

Mire!

Pasqyra paraqet të dhënat që janë futur, operatori bën ndryshimet e nevojshme dhe klikon mbi butonin OK dhe kthehet te pasqyra e mëparshme ku mund të jepen të dhëna të tjera për korrigjim. Ose, operatori mund të anulohet veprimin për t'u kthyer te dritarja e *Konfirmimit të të dhënave të aksidentit*.

Në atë tabelë, kur klikohet mbi butonin *Ruaj* informacioni shkruhet/regjistrohet në bazën e të dhënave, pra është përfunduar futja e të dhënave të *Formularit të regjistrimit të automjetit* dhe përdoruesi kthehet te menuja kryesore.

5.2 Redaktimi i të dhënave

Te Dhenat Baze Te Aksidentit Rrugor		Shfaq te dhena	27 April 2005
Ju Lutem Tregoni Numrin e Aksidenteve		TR/02/23/2005	
Alternat:			
☒ Te Dhenat Te Pergjithshme Te Aksidentit	☐ Perfshirja E Mjete	☐ Moshë E Mjetit	☐ Difektet E Mjetit
☐ Sjellja e Shoferit	☐ Licença e Shoferit	☐ Kombësia e Shoferit	☐ Eksperi. në Drejtim
☐ Sjellja e Këmbësorëve	☐ I Përfshirë në Aksident	☐ Nevojat E Mjetit	☐ Testi i alkohoollit
Selekto tipin e te dhenave qe ju doni te shfaqni		Anullim/ Te Dhenat Baze Te	

Në menunë kryesore të *Aksidentit*, shtypja e butonit *Redaktimi/shikimi i të dhënave* tregon që përdoruesi dëshiron të korrigjojë të dhënat që ka futur.

Operatori duhet të tregojë aksidentin të cilin ai do të redaktojë, d.m.th. të japë numrin e aksidentit. Ai, gjithashtu, duhet të tregojë se cilin lloj informacioni dëshiron të ndryshojë, d.m.th. cila tabelë duhet të korrigjohet. Pasi të ketë bërë këtë, ai fut të dhënat e sakta në tabelat përkatëse, në rastin tonë *Të dhënat bazë të aksidentit rrugor*.

Te Dhenat Baze Te Aksidentit Rrugor		Te Pergjithshme Te Aksidentit, Shfaq	
Aksidenti Nr	TR/02/23/2005	Rrethinat	1 Zonë Rurale
Natyra e Aksidentit	Plagosje Serioze	type i Sipërfaqes	1 Prej bitumi
Data	25/04/2005	Kushtet e Rrugëve	1 e Mirë/premtuese
Ora	19:50	Moti	2 Me shi / i lagësht
Rreth	32 Tirana	Faktorë të tjerë	0 I panjohur
Vendndodhja:	Kryqezimi 4 Plepa	Ogranicenje brazine	1 Po
Rruga Nr	56	km/h	50
X-coord	4560114	Kushtet e Ndrimit	1 Dite
Y-coord	7801152		
Tipi i aksidentit	9 Aut/me këmbësor		
Gjeometria e Rruges	7 X-Kryqëzim		

Selekto tipin e te dhenave qe ju doni te shfaqni Kliko Mire Mire

Ndryshohet informacioni i fushave të prekura dhe kur klikohet butoni *Mirë* operatori kthehet te pasqyra e mëparshme. Në këtë pikë, mund të zgjidhet një tabelë tjetër për t'u ndryshuar ose përdoruesi mund të kthehet te menuja kryesore e aksidentit.

5.3 Fshirja e një aksidenti nga baza e të dhënave

Me kalimin e kohës lind nevoja për të fshirë një aksident i cili mund të jetë regjistruar gabimisht. Kur klikohet mbi butonin *Fshini një aksident* shfaqet kutia e mëposhtme dialoguese:

Te Dhenat Baze Te Aksidentit Rrugor	
Te Dhena Aksidenti, Fshini	
Ju Lutem Tregoni Numrin e Aksidenteve	
Fshini!!	Dalja

Operatori duhet të japë numrin e aksidentit. Më pas, do të shfaqen jo më pak se tri mesazhe paralajmëruese, të cilat i japin atij mundësinë të ndryshojë mendje nëse nuk është i sigurt pasi fshirja nga baza e të dhënave është e pakthyeshme.

5.4 Printimi i informacionit të një aksidenti

Ky opsion zgjidhet kur dikush dëshiron të shohë të gjithë informacionin që është futur për një aksident.

Te Dhenat Baze Te Aksidentit Rrugor

Te Dhena Aksidenti, Shtyp Nje Aksident

Ju Lutem Tregoni Numrin e Aksidenteve

TR/02/23/2005

Shtyp

Dalja

Jepet numri i aksidentit dhe në ekran shfaqet një raport i cili mund të printohet (i shkurtuar).

Aksidenti Nr.		TR/02/23/2005			
Natyra e Aksidentit	2 Plagosje Serioze	Datum	25/04/2005	Sat	19:50
Rreth	32 Tirana	x-coord	45	y-coord	78
Vendndodhja:	Kryqezimi 4 Plepa				
Rruga Nr.:	56				
Tipi i aksidenti	9 I panjohur	Gjeometria e Rruges	7	X-Kryqezim	
Rrethinat	1 Zonë Rurale	Tipi i Sipërfaqes	1	Prej bitumi	
Kushtet e Rrugëve	1 e Mirë/premtuese	Moti	2	Me shi / i lag	
Faktorë të tjerë	0 I panjohur	Kushtet e Ndricimit	1	Ditë	
Limiti i Shpejtësisë	1 Kufiri i Shpejtësisë i shënuar		50		
Automjete te përfshira		Defektet e Automjetit		Moshë e automjetit	
1 1 Makinë, autoveturë	1 3 Frenat	1 4 >12 vjetë			
3 7 Kamion i rëndë >3.5t	1 5 Xhami mbrojtës	2 3 7-12 vjetë			
	2 8 Të tjera				

5.5 Mbledhja e fakteve shtesë për të dhënat ekzistuese

Ndonjëherë mund të lindë nevoja që të shtohet informacion për një aksident i cili është regjistruar tashmë. Kjo mund të ndodhë kur në listën e personave të përfshirë në aksident do të shtohet edhe një pasagjer. Gjithashtu, mund të ndodhë edhe kur në aksident janë përfshirë më shumë se katër automjete.

Kur përzgjidhet ky opsion, menuja kryesore paraqet tabelën e mëposhtme:

Te Dhenat Baze Te Aksidentit Rrugor

Mbledhja e fakteve per te Dhenat Ekzistuese

Alternativat:

☐ Sjellja e Shoferit ☒ **Perfshirja E Mjete** ☐ Difektet E Mjetit ☐ Moshja E Mjetit ☐ Nevojat E Mjetit
☐ Sjellja e Këmbësorëve ☐ Licensa e Shoferit ☐ Kombësia e shoferit ☐ Eksperienca në drejtim ☐ Testi i alkohoolit
☐ I Përfshirë në Aksident

Selekto tipin e te dhenave qe ju doni te shfaqni

Anullo/ Te Dhenat Baze Te Aksidentit Rrugor

Si zakonisht, operatori duhet të përzgjedhë llojin e informacionit që shtohet. Nëse, për shembull, do të shtohet një automjet te *Lloji i mjetit*, atëherë shfaqet pasqyra e mëposhtme:

Te Dhenat Baze Te Aksidentit Rrugor

Perfshirja E Mjeteve, Sho te dhena

1=Makinë, autoveturë 2=Mikrobuz, 8+1 3=Minibuz, > 8+1 4= Autobuz
 5=Kamionçinë <3.5t 6=Automjete sportive 7=Kamion i rëndë >3.5 t 8=Kamion i
 rëndë + trailer 9=Motorçiklete 10=Karrocë me kafshë 11=Biçikletë 12=Traktor
 ferme 13=Të tjera

Aksidenti Nr	Mjetit Nr	Tipi
▶	0	0

Selekto tipin e te dhenave qe ju doni te shfaqni, Kliko Mire

Mire

Jepet numri përkatës i aksidentit si te numri i automjetit, ndoshta 3, nëse ka tashmë informacion për dy automjete të tjera, si dhe kodi përkatës për tipin e automjetit. Kur klikohet butoni *Mirë* kthehemi te menuja e mëparshme.

5.6 Fshirja e fakteve nga të dhënat ekzistuese

Njëkohësisht, mund të lindë nevoja edhe për të fshirë informacion nga një aksident i regjistruar tashmë në bazën e të dhënave. Nëse, për shembull, në fillim të regjistrimit të të dhënave ishin regjistruar më shumë se një drejtues automjeti , kjo e dhënë mund të fshihet.

Do të shfaqet pasqyra e mëposhtme:

Te Dhenat Baze Te Aksidentit Rrugor

Fshini Faktet nga te Dhenat Ekzistuese

Ju lutem trego numrin e aksidentit nga i cili ju doni te fshini nje rregjistrim

TR/02/23/2005

Ju lutem sektoni ti pin e te dhenave qe ju deshironi te fshini

Alternativat

☐ Sjellja e shoferit

☐ Perfshirja E Mjete

☐ Difektet E Mjetit

☐ Mosha E Mjetit

☐ Nevojat E Mjetit

☐ Sjellja e Kembësorëve

☐ Licensa e Shoferit

☐ Kombësia e Shoferit

☐ Eksperienca në drejtim

☐ Testi i alkohoolit

☒ I Përfshirë në Aksident

Mire

Anulim/
Rikthimi Ne Trajten e
Meparshme

Si zakonisht, operatori duhet të tregojë llojin e të dhënës që do të fshihet. Në rastin e një drejtuesi automjeti, e dhëna do të ishte *I përfshirë në aksident*.

Te Dhenat Baze Te Aksidentit Rrugor

I Përfshirë në Aksident, Shto te dhenat

Aksidenti Nr	Person no	Kategoria	Mjetit	Gjinia	Mosha	Plagosje	Perdorimi Rripi/Helmet
TR/02/23/2005	1	1	1	1	21	3	2
TR/02/23/2005	2	3	1	2	52	1	3
▶ TR/02/23/2005	4	3	2	2	22	4	2
*	0	0	0	0	0	0	0

Ju lutem beni ndryshimet dhe pastaj dhe Kliko Mire

Mire

Kategoria e Përdoruesit të rrugës

1 = Shofer
2 = Pasagjer
3 = Kembësor
4 = Ciklist
5 = Motociklist
6 = Te tjerë

Gjina

1 = Maskull
2 = Femra

Vrsta povrede

1 = Vrarë
2 = Rëndë
3 = Lehtë
4 = Jo Plagosje

Rripi/Helmet

1 = Po
2 = Jo

Pasi të përzgjidhet e dhëna që duhet fshirë, përdoruesi duhet të shtypë butonin *Delete* (Fshij) në tastierë dhe pastaj të përgjigjet *Yes* (Po), kur pyetet nëse dëshiron që të fshijë të dhënën e përzgjedhur. Kjo është një procedurë standarde për fshirjen e të dhënave në *MS Access*.

5.7 Ndryshimi i numrit të aksidentit

Në raste të rralla lind nevoja për ndryshimin e numrit të aksidentit. Nëse, gabimisht, numri i aksidentit është regjistruar *TR/002/27/2004* në vend të *TR/002/27/2005*, atëherë numri i aksidentit duhet ndryshuar.

Te Dhenat Baze Te Aksidentit Rrugor

**Ndryshimi i Numrit
te Aksidenteve**

Numri I Vjeter I Aksidentit

TR/002/27/2004

Ndryshimi i Numrit te Aksidenteve!

Numri I Ri I Aksidentit

TR/002/27/2005


Dalja

Numri i aksidentit do të ndryshohet automatikisht në të 12 tabelat.

5.8 Mbajtja e kopjes rezervë të bazës së të dhënave

Ky opsion kopjon tabelën e të dhënave *albaniadata.mdb*, në direktorinë *c:\road_safety_database\database backup* (si kopje rezervë). Sigurisht që i zoti i kompjuterit duhet të garantojë që rutinat e rezervave janë aktive në kompjuter për të kopjuar informacionin e vlefshëm në një vend të ndarë nga kompjuteri. Nëse nuk përdoret kasetta rezervë, rekomandohet që baza e të dhënave dhe aplikimi të kopjohen në një CD-ROM.

Kur shtypet ky buton, shfaqet konfirmimi i mëposhtëm:



5.9 Mirëmbajtja e bazës së të dhënave

Mirëmbajtja e bazës së të dhënave me një numër të madh rekordesh dhe ndryshorësh do të thotë që lind nevoja për të pasur funksione të cilat kontrollojnë informacionin e pasaktë që nuk janë dalluar në momentin e futjes së të dhënave në program. Në rastin tonë, baza e të dhënave organizohet në dymbëdhjetë tabela të ndryshme dhe lind nevoja të kontrollohen të dhënat teke, të dhënat që ekzistojnë në një tabelë por jo në të tjerat.

Për shembull, informacioni rreth një aksidenti në tabelën e sjelljes së këmbësorit duhet të jetë edhe në tabelën e të dhënave të përgjithshme. Të gjitha aksidentet duhet të kenë të paktën informacionin e përgjithshëm rreth aksidentit, informacionin e automjetit, sjelljen e drejtuesit të automjetit dhe të personave të përfshirë në aksident.

Miratimi Pjeses

☐ Dokumentat Ndodhen Ne Te Ddhenat E Pergjshme Te Aksidentit Por Jo Ne te Dhenat E Sjelljes Se Shoferit

☐ Dokumentat Ndodhen Ne Te Ddhenat E Pergjshme Te Aksidentit Por Jo Ne te Dhenat E Mjetit

☐ Dokumentat Ndodhen Ne Te Ddhenat E Pergjshme Te Aksidentit Por Jo Ne te Dhenat E Personave Te Perfshire

☐ Ashpra = Plagosja Te Lehta, Plagosje = Vdekje Ose Plagose Te Ashpra

☐ Ashpra = Plagosje Serioze, plagosje=Fatale

☒ Ashpra = Fatale, Plagosj Jo Fatale

☐ Lloji I Aksidentit = Kembesor, Jo Sjellja E Kembesorit

Mire

Dalja

Në rastin e parë, ne duam të dimë nëse kemi ndonjë aksident fatal ku nuk kishte dëmtime të regjistruara fillimisht.

Kur klikohet butoni *Mirë* shfaqet pasqyra e mëposhtme:

	accident no	severity	date	time	rreth	injury
▶	FR/02/12/2005	1	12/04/2005	12:22:00	2	4
	TR/01/23/2005	1	12/03/2005	11:23:00	2	4
	TR/02/0123/2005	1	25/04/2005	21:30:00	32	3
	TR/01/34/2005	1	12/01/2005	11:00:00	32	4
*						

Siç duket, janë katër aksidente ku *Serioziteti* është *Fatal* (kodi=1) por kodi i dëmtimit nuk është *Vrarë* (kodi=1). Duhet të bëhet një rishqyrtim për t'u siguruar se cili prej kodeve është gabim, *Serioziteti* ose *Vrarë*.

5.10 Importimi i të dhënave

Ky opsion jep mundësinë e importimit të të dhënave nga një pozicion, direktori, CD ose rrjet tjetër. Tabela e të dhënave që do të importohet duhet të ketë patjetër të njëjtën strukturë të dhënash. Një skenar i mundshëm mund të jetë që futja e të dhënave është bërë në disa pozicione të ndryshme dhe më vonë bëhet bashkimi i tyre në një.

Kur shtypet ky buton jepet dritarja dialoguese e cila e fton përdoruesin të zgjedhë pozicionin nga ku do të importohet tabela e të dhënave:



Siç mund të shihet, aty hapet një dritare dialoguese standarde *Windows* dhe pasi të jepet pozicioni fillon importimi. Nëse importimi i tabelës së të dhënave është i suksesshëm, atëherë numri i rekordeve në tabelë që jepet në menunë kryesore do të përshtatet përkatësisht. Nëse importimi i tabelës së të dhënave dështon, atëherë numri i rekordeve në tabelë mbetet i njëjtë.

5.11 Eksportimi i të dhënave

Njëkohësisht, të dhënat e aksidenteve mund të eksportohen në një bazë tjetër të dhënash *Access*. Të dhënat mund të përzgjidhen nga data, për shembull, nëse duam, mund të përzgjedhim një vit të tërë. Në këtë rast shfaqet pasqyra e mëposhtme:

Te Dhenat Baze Te Aksidentit Rrugor

Eksportoni Te Dhenat

Nisja e Te Dhenave:

Mbyllja e te Dhenave: Date format dd/mm/yyyy "01/01/2005"

Te dhenat Baze Jane Ruajtur ne Manualin "C:\road_safety_database" nen emrin "eksport.mdb"

Siç edhe mund të shihet, tabela quhet *eksport.mdb* dhe ndodhet/ruhet në direktorinë *c:\road_safety_database*.

5.12 Pasqyra e rrjetit të rrugëve lokale

Më në fund, aplikimi i ofron përdoruesit mundësinë për të parë rrjetin e rrugëve lokale. Kjo është një dosje në *Excel* dhe jep informacion të detajuar mbi rrjetin e rrugëve lokale të rrethit.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E PUSHTETIT VENDOR DHE DECENTRALIZIMIT

DREJTORIA E INVESTIMEVE

INVENTARI I RRUGEVE RURALE

QARKU BERAT

Nr.	RRETHI - KOMUNA	EMERTIMI I RRUGEVE	GJATESIA GJITHSEJ	KLASIFIKIM
				Rajonal
1	2	3	4	5
A	RRETHI BERAT			
1101	Komuna CUKALAT	Rruga Donofrose - Cukalat	3.5	-
1102		Rruga Donofrose - Slanice	1.5	-
1103		Velmisht - Donofrose	4	4
1104	Komuna KUTALLI	Rruga Kutalli - Gorican	4	-
1105		Pobrat-Donofrose	4.2	
1106		Rruga Kutalli - Samatice	5	-
1107	Komuna POSHNJE	Rruga Syzeze - Banjaj	1.4	-
1108		Rruga Syzeze - Grope	1.8	-
1109		Rruga Ciflik - Arrez - Polican	5	-
1110		Ura Kucit - Gorican	5	-
1111	Komuna OTLLAK	Rruga Kthesa - Dyshnik - Dushni	1.1	-
1112	Komuna VERTOP	Rruga per ne Kapinove	11	-

BAZA E TË DHËNAVE TË AKSIDENTEVE RRUGORE

Manual për analizën e të dhënave

1. Parathënie

Të pasurit në dispozicion i të dhënave të aksidenteve rrugore, është një domosdoshmëri për çdo sistem të menaxhimit të sigurisë rrugore. Të dhënat e azhurnuara të aksidenteve janë të nevojshme për identifikimin e problemeve të sigurisë rrugore dhe për ngritjen e informacionit publik. Të dhënat e aksidenteve janë një element vendimtar për çdo ndërhyrje të sigurisë rrugore, me qëllim parandalimin e aksidenteve rrugore.

Por nuk janë vetëm përshkrimi i rrethanave të aksidentit të nevojshme. Ndihma e faktorëve të tillë, si: karakteristikat e rrugës dhe të trafikut, parametrat e mjeteve lëvizëse, informimi për personat e përfshirë në aksident, duhet të jenë të regjistruara po aq mirë.

Sistemi i të dhënave të aksidenteve (SDA) zbatohet për të gjithë rrjetin rrugor shqiptar.

Programi bazohet në kompetencën e policisë rrugore, për të kryer një hetim të aksidentit, si dhe një raport mbi rrethanat e aksidentit. Të dhënat e hedhura përpunohen dhe analizohen, me qëllim që:

- të përdoren nga vetë policia për plane strategjike në marrjen e veprimeve për të përmirësuar sigurinë rrugore;

- të përdoren nga organizma të tjerë përgjegjës për sigurinë rrugore për hartimin dhe zbatimin e strategjive gjithëpërfshirëse;

- të përdoret nga entet pronare të rrugëve; si dhe

- nga institucione të tjera të përfshira në sigurinë rrugore.

Mbledhja e të dhënave bëhet nga shërbimet e policisë rrugore që operojnë në vendndodhje duke plotësuar raportin e aksidentit rrugor.

Për të bërë një analizë efektive, për të nxjerrë konkluzione sa më të sakta, nga të dhënat është e nevojshme që të plotësohen këto kërkesa thelbësore:

- saktësia (për të përshkruar saktësisht parametrat e veçantë);

- kompleksiteti (për të përfshirë të gjitha veçoritë brenda sistemit të dhënë);

- disponueshmëria (që të jenë të disponueshme nga të gjithë përdoruesit);

- njëtrajtshmëria (për t'u përdorur përcaktime standarde).

Parametri i fundit (njëtrajtshmëria) është i një rëndësie të veçantë për krahasimet. Edhe në nivel kombëtar është e rëndësishme që edhe përcaktimet lokale të përputhen me ato kombëtare.

Shumë studime të sigurisë rrugore janë të drejtuara në përmirësimin e cilësisë së parametrave të rrugëve. Problemi më i madh kur drejton këto studime është përcaktimi i vendndodhjes së saktë të aksidentit. Si pasojë, disponueshmëria e një metode lokalizimi, është një element kryesor për çdo sistem informimi rrugor. Pa një njohuri të besueshme të vendndodhjes së aksidentit dhe pa të dhëna të përshtatshme, mundësitë për të zgjidhur të metat lokale janë të limituara.

Një pikë rreziku (*blackspot*) është një term që përdoret në menaxhimin e sigurisë rrugore për të përcaktuar një vend ku aksidentet janë të përqendruara. Pa një lokalizim të saktë të aksidenteve rrugore, specialistët e sigurisë rrugore, nuk janë në gjendje të gjejnë dhe të trajtojnë me efektivitet pikat e rrezikut në rrjetin e tyre të rrugëve. "Lokalizime të pasakta" do të thotë identifikime të gabuara dhe humbje në kohë dhe në anën financiare.

2. Përkufizime

"Ngjarje rrugore", ngjarje që ndodh në një rrugë publike ose në një rrugë private në të cilën publiku ka të drejtën e aksesit. Përfshin të paktën një automjet në lëvizje me të paktën një person të plagosur apo të vrarë, si dhe ato vetëm me dëme materiale, të raportuar nga shërbimet e policisë rrugore.

"Ngjarje rrugore vetëm me dëme materiale", ngjarje që ndodh në një rrugë publike ose në një rrugë private në të cilën publiku ka të drejtën e aksesit. Përfshin të paktën një automjet në lëvizje, vetëm me dëme materiale, të raportuar nga shërbimet e policisë rrugore.

"Aksident rrugor", ngjarje që ndodh në një rrugë publike ose në një rrugë private në të cilën publiku ka të drejtën e aksesit. Përfshin të paktën një automjet në lëvizje me të paktën një person të plagosur apo të vrarë, të raportuar nga shërbimet e policisë rrugore.

"Personi i vrarë në 30 ditë", vdekja brenda 30 ditëve për shkak të aksidentit rrugor.

"Aksident fatal", aksidenti me të paktën një person të vrarë ndërmjet personave të tjerë të përfshirë, pavarësisht nga serioziteti i plagosjes.

“Aksident me plagosje”, aksidenti me të paktën një person të plagosur ndërmjet personave të përfshirë, pa specifikimin e llojit të plagosjes.

“Aksident me plagosje të rënda”, aksidenti që ka sjellë si pasojë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim tjetër të përhershëm të shëndetit, ndërprerjen e shtatzënisë ose ka qenë i rrezikshëm për jetën në çastin e shkaktimit të tij.

“Aksident me plagosje të lehta”, aksidenti që ka shkaktuar te personat e përfshirë, paaftësi të përkohshme më tepër se 9 (nëntë) ditë.

“I panjohur”, aksidenti për të cilin nuk raportohet serioziteti i plagosjes në mesin e personave të përfshirë.

“Përplasje këndore”, përplasje ndërmjet automjeteve që lëvizin. Automjeti i parë ka një pikë përplasjeje anësore, automjetet e tjera kanë një pikë përplasjeje ballore.

“Përplasje zinxhir”, përplasje ndërmjet më shumë se dy automjeteve që lëvizin. Automjeti i parë ka një pikë përplasjeje të pasme, automjeti tjetër ka një pikë përplasjeje ballore, e kështu me radhë dhe për automjetet e tjera që vijnë pas.

“Përplasje me kafshë”, përplasje ndërmjet automjeteve dhe kafshëve.

“Përplasje me pengesën”, përplasje ndërmjet automjetit në lëvizje dhe pengesës, në ose jashtë rrugës.

“Pengesë fikse ose në lëvizje” përfshin pemë, postera, barrierat e sigurisë, pjesë të infrastrukturës rrugore ose ndërtime të ndryshme etj.

“Përplasje me makinë të parkuar”, përplasje ndërmjet mjetit që lëviz dhe automjetit të parkuar.

“Përplasje me këmbësorin”, përplasje ndërmjet automjetit që është duke lëvizur dhe këmbësorëve.

“Përplasje ballore”, përplasje ndërmjet dy automjeteve që udhëtojnë në drejtim të kundërt në të njëjtën rrugë. Të dyja automjetet kanë një pikë përplasjeje ballore.

“Përplasje anësore”, përfshin përplasje këndore, përplasje krah për krah. Automjeti i parë ka një pikë përplasjeje anësore, automjetet e tjera kanë një pikë frontale ose përplasjeje anësore.

“Aksident i një automjeti të vetëm, kur nuk ka pengesa”, aksidenti në të cilin është përfshirë vetëm një automjet. Përfshin automjetin të dalë nga rruga.

“Përplasje krah për krah”, përplasje ndërmjet dy automjeteve, ku të dyja automjetet kanë një pikë përplasjeje anësore.

“Përplasje e pasme”, përplasje ndërmjet dy automjeteve që udhëtojnë në të njëjtin drejtim në të njëjtën rrugë. Automjeti i parë ka një pikë të pasme përplasjeje, automjeti tjetër ka një pikë ballore përplasjeje.


“Pikë rreziku” është vendi ku në një segment rruge me rreze 300 m, kanë ndodhur të paktën dy aksidente me pasojë vdekje apo plagosje të rëndë, brenda një periudhe 3-vjeçare.

3. Hyrje

Baza e të dhënave të aksidenteve rrugore, në bazë të formularit të regjistrimit të aksidenteve (raporti i aksidentit rrugor), përmban informacion për 32 të dhëna të ndryshme që kërkohet të plotësohen për një aksident rrugor, përkatësisht:

- | | | |
|--|-------------------------------------|--------------------------|
| - Viti | - Muaji | - Ditë jave |
| - Ora | - Rrethi | - Qarku |
| - Rruga | - Serioziteti | - Tipi i aksidentit |
| - Rrethinat | - Tipi i sipërfaqes | - Gjeometria e rrugës |
| - Kushtet e rrugës | - Moti | - Kushtet e ndriçimit |
| - Faktorë të tjerë | - Lloji i automjetit | - Defektet e automjetit |
| - Kufiri i sipërm i lejuar i shpejtësisë | - Mosha e automjetit | - Sjellja e drejtuesit |
| - Kërkesat e automjeteve | - Leja e drejtimit | - Eksperienca në drejtim |
| - Kombësia drejtuesit të automjetit | - Testi i alkoolit | - Sjellja e këmbësorëve |
| - Kategoria e përdoruesve të rrugës | - Gjinia | - Grup-mosha |
| - Lloji i plagosjes/dëmtimit | - Përdorimi rripit/kaskës mbrojtëse | |

Komponentët kryesorë të bazës së të dhënave janë:



Të dhënat e pamanipuluara mbahen të ndara në dosjen *albaniadata.mdb*, në fund, ndërkohë që moduli i futjes së të dhënave *albaniaentry.mdb* dhe moduli i analizimit *albaniaanalysis.mdb* në fillim, shkruajnë dhe lexojnë të dhënat nëpërmjet lidhjeve që krijohen nga sistemi.

Të gjitha dosjet ruhen në direktorinë *c:\road_safety_database*.

Baza e të dhënave përbëhet nga 12 tabela kryesore ku mbahen të dhënat e mëposhtme:

- të dhëna të përgjithshme të aksidentit
- defektet e automjetit
- mosha e automjetit
- përvoja në drejtim
- sjellja e drejtuesit të automjetit
- sjellja e këmbësorëve
- lloji i automjetit
- nevojat e automjetit
- dëshmia e drejtuesit të automjetit
- kombësia e drejtuesit të automjetit
- testi i alkoolit
- përfshirja në aksident

Tabelat kanë një kolonë të përbashkët, *Nr. i aksidentit*, e cila është kolona kryesore që bashkon të dhënat e të gjithë bazës së të dhënave. Përveç kësaj ka edhe shumë tabela të tjera ndihmëse me tituj për kodet e ndryshme që përdoren.

Kjo është baza e futjes së të dhënave (*Input Database*) ku i gjithë informacioni ruhet si kode që përfaqësojnë vlera të vërteta. Për shembull, në fushën *Rrethinat* kodi 1 do të thotë *Zonë rurale*, kodi 2 do të thotë *Zonë urbane* dhe kështu me radhë. Megjithatë, për përdoruesin përfundimtar të të dhënave këto kode nuk kanë kuptim, kështu që në modulën e Analizimit krijohet një bazë leximi të dhënash (*Output Database*), që i konverton këto vlera numerike në tekst siç ilustron me poshtë me fushën *Rrethinat*.

0	I panjohur
1	Zonë Rurale
2	Zonë Urbane
3	Shesh

Përveç kësaj, në bazën e leximit shtohen edhe ndryshoret e mëposhtme në bazë të informacionit të futur fillimisht:

Ndryshorja **E gjeneruar nga fusha**

Qarku	Rrethi
Viti	Data
Muaji	Data
Dita e javës	Data
Ora	Koha
Grup-mosha	Mosha

4. Kërkesat e sistemit, instalimi dhe vënia në punë:

- sistemi kërkon një kompjuter me të paktën 128 MB memorie të RAM-it;
- kompjuteri duhet të ketë të paktën 500 MB zonë të lirë në njësinë qendrore të njësise C:\.;
- kompjuter me sistem operimi *Windows XP/98/2000/NT*;

- KOMPJUTER me paketë *Office 2003 Professional* që përmban modulet *MS Access*, *MS Excel*, *MS Query*, *MS Word* dhe njësi (database) ODBC;

- menutë janë projektuar për rezolucion ekrani nga 600 deri në 800 pixels.

Shënim 1. Nëse paketa *MS Office Professional* nuk është instaluar siç përshkruhet më sipër, aplikimi i analizimit nuk do të funksionojë!

Shënim 2. Për të shmangur paralajmërimet e sigurisë në *Access 2003*, veprohet si më poshtë: Nga menuja kryesore në *MS Access*, shkohet në *Tools_Macro_Security* ku përzgjidhet opsioni *Low*:



Ky opsion lejon përdorimin e makrove dhe kodit *Visual Basic* pa paraqitur në ekran paralajmërimin normal.

Aplikimi është zhvilluar në *MS Access 2003* që përdor *MS Excel*, *MS Query* dhe *MS Word* për prezantimin e të dhënave.

Instalimi bëhet nëpërmjet programit *Setup* që jepet në CD. Gjithashtu, mund të bëhet edhe mekanikisht, duke kopjuar dosjet *albaniaadata.mdb*, *albaniaentry.mdb* dhe *albaniaanalysis.mdb* nga CD-ja në direktorinë *c:\road_safety_database*.

Kini parasysh që, nëse dëshironi të punoni direkt në *MS Access*, duke anashkaluar aplikimin, kjo është e mundur nëse veprohet si vijon: Duke përdorur *Windows Explorer*, klikoni dy herë mbi dosjen *albaniaentry.mdb*, duke mbajtur të shtypur tastin *Shift*. Baza e të dhënave do të hapet në model *MS Access*. Për të filluar aplikimin që këtu, hapni formën *FWelcome*.

Për të filluar aplikimin normalisht, klikohet mbi ikonën e instaluar në desktop (ekranin e kompjuterit). Aplikimi mund të fillohet edhe nga klikimi dy herë mbi dosjen *albaniaentry.mdb* që gjendet në direktorinë *c:\road_safety_database*.

Shënim 3. Aplikimi është i lidhur me të dhënat e dosjes *albaniaadata.mdb* në direktorinë *c:\road_safety_database*. Kjo bëhet automatikisht nga aplikimi dhe në qoftë se lidhjet humbasin rastësisht ato mund të rikthehen duke përdorur *Link Table Manager in MS Access (Tools_Database Utilities_Linked Table Manager)*.

5. Menuja kryesore

Pas ekranit mirëseardhës shfaqet menuja kryesore, që jepet më poshtë:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Statistikat E Aksidenteve Rrugore Të Shqiperise

Të Dhena Aksidenti Rrugor, Analiza

Permbajtja e të Dhenave Baze

Permbajtja e të Dhenave Baze	Asnje e Dhene
Të Pergjithshme të Aksidentit	1011
Perfshirja e Mjeteve	1025
Difektet e Mjetit	2023
Kërkesat e automjeteve	2062
Mosha e Mjetit	2023
Sjellja e Shoferit	2027
Licensa e Shoferit	2020
Kombësia e Shoferit	2025
Eksperienca në Drejtim	2025
Testi i Alkohoolit	2024
Sjellja e Këmbësorëve	131
Përfshirë në Aksident	3027

Shihni Raportin E Aksidentit

Azhomim Dhënave Bazë

Berja E Një Raporti

TABLE

Tabela në të majtë tregon se sa rekorde aksidentesh kanë 12 tabelat e bazës së të dhënave, d.m.th., sa e madhe është baza e të dhënave.

Në menu ka vetëm tri opsione:

- Shihni raportin e aksidentit;
- Përditësimi i të dhënave bazë;
- Bërja e një raporti.

5.1 Paraqitja e formularit të aksidentit

Kur zgjidhet ky opsion hapet *Formulari i aksidentit* në programin *Excel* që është vetëm i lexueshëm:

[illegible]

5.2 Azhurnimi i bazës së leximit të të dhënave (*Output Database*)

Siç u shpjegua në kapitullin 1, “Hyrje”, moduli i analizimit përdor një bazë leximi të dhënash (*Output Database*), që gjenerohet nga informacioni i bazës së futjes së të dhënave (*Input Database*). Kodet “e pakuptimta” numerike nga baza e futjes së të dhënave (*Input Database*) konvertohen në tekst “me kuptim” në bazën e leximit të të dhënave (*Output Database*). Përveç kësaj, shumë ndryshore, si: muaji, dita e javës dhe qarku në bazën e futjes së të dhënave (*Input Database*) janë të ndara në fusha.

Normalisht, pas njëfarë kohe nga futja e të dhënave, në bazën e të dhënave do të krijohet një rrëmujë (mishmash) në numrin e aksidenteve në bazën e futjes së të dhënave (*Input Database*) dhe asaj të leximit të të dhënave (*Output Database*). Për t'u sqaruar: Le të supozojmë që të dyja bazat (*Input* dhe *Output*) kanë nga 1000 aksidente. Kur në bazën e të dhënave futen edhe 50 aksidente të tjera, pra kemi 1050 aksidente në *Input Database*, baza e leximit të të dhënave (*Output Database*) vazhdon të mbulojë vetëm 1000 aksidente.

Kështu që lind nevoja e azhurnimit të bazës së leximit të të dhënave (*Output Database*) dhe kjo bëhet duke shtypur butonin e azhurnimit në *Menu*. Azhurnimi i duhur i bazës së leximit të të dhënave (*Output Database*) para shpërndarjes të palët e interesuara është detyra e administratorit të sistemit. Megjithatë, edhe nëse kjo harrohet, funksioni është i aktivizuar në mënyrë që një gjë e tillë të mund të bëhet edhe nga përdoruesi i sistemit, duke mënjanuar vonesat e mundshme në analizimin e të dhënave.

Për më tepër, kur hapet menuja kryesore bëhet edhe një kontroll për sinkronizmin e *Input Database* me atë të *Output Database*. Në rast të kundërt shfaqet një dritare paralajmëruese me mesazhin:



Shënim. Për shkak të veçorisë së punës së *MS Access*, rekomandohet që pas azhurnimit të dilet nga aplikimi për të lejuar *MS Access* të kompakttojë bazën e të dhënave. Procesi i shndërrimit rrit përkohësisht madhësinë e bazës së të dhënave e cila nuk korrigjohet dinamikisht nga *MS Access* kështu që procedura e kompaktimit bëhet kur aplikimi është i mbyllur. Puna e bazës së të dhënave përmirësohet pasi është përfunduar kompaktimi.

Administratori i sistemit duhet të vendosë, gjithashtu, për datën e *cut-off* të azhurnimit. Nëse për shembull, synohet analizimi i situatës së aksidenteve rrugore në tremujorin e parë të vitit 2005, të gjitha aksidentet e periudhës janar–mars 2005 duhet të jenë të raportuara.

Nëse shtypet butoni *Azhurnim i të dhënave bazë*, në të djathtë të ekranit do të shfaqet një matës, i cili tregon progresin e bazës së leximit të të dhënave (*Output Database*). (Kjo veçori është e dobishme kur rritet baza e të dhënave.)

Gjithashtu, në ekran do të shfaqet edhe konfirmimi i operacionit:



5.3 Prodhimi i një raporti

Butoni i tretë, *Bërja e një raporti*, fillon dialogun interaktiv i cili finalizon raportin. Këtu përfshihen vetëm tre hapa, përzgjedhja e të dhënave, përzgjedhja e rreshtit dhe kolonës së ndryshores së raportit dhe gjenerimi i raportit.

5.3.1 Përzgjedhja e të dhënave

Përveç rasteve kur doni të raportoni të gjithë bazën e të dhënave, ju duhet të specifikoni të dhënat mbi të cilat duhet të bazohet raporti. E dhëna mund të jetë e përgjithshme, si: *viti 2005*, *Qarku Elbasan* ose specifik si *Të gjitha aksidentet me biçikletë me pasojë vdekjen në Tiranë gjatë vitit 2004 dhe 2005*.

Përzgjedhja mund të bëhet edhe për njërën nga 32 ndryshoret e përfshira në bazën e të dhënave:

- | | | |
|---------------------------------------|-------------------------------|--------------------------|
| - Viti | - Muaj i | - Ditë jave |
| - Ora | - Rrethi | - Qarku |
| - Rruga | - Serioziteti | - Tipi i aksidentit |
| - Rrethinat | - Tipi i sipërfaqes | - Gjeometria e rrugës |
| - Kushtet e rrugëve | - Moti | - Kushtet e ndriçimit |
| - Faktorë të tjerë | - Lloji i automjetit | - Defektet e automjetit |
| - Kufizimi i afishuar i shpejtësisë | - Moshë e automjetit | - Sjellja e shoferit |
| - Kërkesat e automjeteve | - Leje drejtimi | - Eksperienca në drejtim |
| - Kombësia e drejtuesit të automjetit | - Testi i alkoolit | - Sjellja e këmbësorëve |
| - Kategoria e përdoruesve të rrugës | - Gjinia | - Grup-moshë |
| - Lloji i plagosjes/dëmtimit | - Përdorimi i rripit/helmetës | |

Shënim. Të gjitha kriteret e përzgjedhjes ndjekin kushtin DHE. Nëse doni të përzgjidhni Tiranën ose Durrësin, ju duhet të kërkonit raporte të veçanta për Tiranën dhe Durrësin dhe më pas t'i mblidhni rezultatet.

Nëse doni të raportoni të gjithë bazën e të dhënave, *Viti i fillimit* duhet të jetë viti 2004 dhe *Viti i fundit* duhet të jetë viti 2005, duke presupozuar që aksidentet më të hershme janë nga viti 2004 dhe ato

më të fundit janë nga viti 2005.

Mund të thuhet që të gjitha raportimet/kërkimet në bazën e të dhënave kanë një element kohe, qoftë i gjithë viti ose pjesë të tij siç është tremujori.

Ekрани i përzgjedhjes së të dhënave duket si më poshtë:

Pjesa 1

Të Dhëna Aksidenti Rrugor, Analiza			
Përzgjidhni Popullsinë Për Raportin Tuaj			
Mbarimi i Formularit Të Kontrollit = Përzgjidhni Gjithshka			
Qartëso Kriteret E Përzgjedhur			
1. Dimensioni Kohor			
Fillim Viti: 2005	Fund Viti: 2005	Data Fillimit:	Data Fundit:
Përzgjidh Këto Kriteria			
2. Përmasat Gjeografike			
Qarku			
☐ Berat	☐ Dibër	☐ Durrës	☐ Elbasan
☐ Korçë	☐ Kukës	☐ Leshë	☐ Shkodër
☐ Fier	☐ Gjirokastrë	☐ Tiranë	☐ Vlorë
Rreth: Rrugës:			
3a. Ashpërsi			
☐ Fatal ☐ Plagosje Serioze ☐ Plagosje E Lehtë/Minore			
3b. Tipi i Aksidentit			
Lista Mëposhtëme Për të Vazhduar			

Pjesa 2

4. Mjedisi Aksidentit			
etria e Rrugës	Rrethinat	Kushtet e Rrugëve	
i I Sipërfaqes	Moti	Kushtet e Ndricimit	
ktorë të tjerë	Limiti i Shpejtësisë i shënuar		
5. Automjete të Përfshira			
Tipi i Automjete	Kërkesat		
Defektet e Mjetit	Mosha e Automjetit		
6. Shofer			
Sjellja e Shoferit	Licensa e Udhëtimit		
perienca në drejtim	Kombësia e Shoferit		
llja e Këmbësorëve	Testi i Alkoolit		

Pjesa 3

7. I Përfshirë në Aksident				
Kategoria e Përdoruesit të Rrugës ☐ Shofer ☐ Pasagjer ☐ Këmbësor ☐ Çiklist ☐ Motorgjiliste ☐ Të tjere	Gjinia ☐ Maskull ☐ Femra	Grup Moshë ☐ 1-10 ☐ 11-17 ☐ 18-24 ☐ 25-44 ☐ 45-64 ☐ ≥65	Lloji i Plagosjes ☐ Vrare ☐ Rëndë ☐ Lehtë	Përdorimi/Ripit/Helmet ☐ Përdorues ☐ Mospërdorues

Në shembullin e mësipërm, vetëm aksidentet e vitit 2005 mund të përzgjidhen.

Kur përzgjedhim *Të gjitha aksidentet e këmbësorëve me pasojë vdekjen në Tiranë gjatë tremujorit të parë të vitit 2005* do të kemi dritaren e mëposhtme:

Të Dhëna Aksidenti Rrugor, Analiza					
Përzgjidhni Popullsinë Për Raportin Tuaj					Qartëso Kriteret E Përzgjedhur
Mbarimi i Formularit Të Kontrollit = Përzgjidhni Gjithshka					
1. Dimensioni Kohor					
Fillim Viti: 2005	Fund Viti: 2005	Data Fillimit: 01/01/2005	Data Fundit: 31/03/2005	Përzgjidh Keto Kriteria	
2. Përmasat Gjeografike					
Qarku					
☐ Berat	☐ Dibrë	☐ Durrës	☐ Elbasan	☐ Fier	☐ Gjirokastrë
☐ Korçë	☐ Kukës	☐ Lezhë	☐ Shkodër	☒ Tiranë	☐ Vlorë
Rreth		Rrugës			
3a. Ashpërsi					
☒ Fatal ☐ Plagosje Serioze ☐ Plagosje E Lehtë/Minore					
3b. Tipi i Aksidentit					
Aut/me këmbësor					
Lista Mëposhtme Për të Vazhduar					

Klikimi i këtij butoni rivendos të gjitha kriteret e përzgjedhjes:

Qartëso Kriteret E Përzgjedhur

Për të ekzekutuar përzgjedhjet dhe për të vazhduar me butonin e raportit, klikohet mbi butonin e mëposhtëm:



Pas kësaj shfaqet dritarja e mëposhtme që konfirmon përzgjedhjen e kriterëve:



Duke qenë se, në varësi të madhësisë së bazës së të dhënave, operacioni i kërkuar mund të marrë kohë, në ekran shfaqet një dritare tjetër që tregon se puna e kërkuar është në progres:



5.3.2 Përzgjedhja e rreshtit dhe e kolonës së ndryshores

Në këtë ekran ju tregoni rreshtin dhe kolonën ku ndodhen ndryshoret që duhet të përlogariten.

Shënim. Kur përzgjidhni rreshtin dhe kolonën e ndryshores ju duhet të keni parasysh që numri i zërave bën disa ndryshore si të papërshtatshme. Për shembull, ndryshorja, sjellja e shoferit, me 17 zëra të ndryshëm, do të krijojë aq shumë kolona saqë do të jetë i vështirë leximi i tabelës në një fletë të kthyer *portrait* (për së gjati).

Statistikat E Aksidenteve Rrugore Të Shqipërisë

20

Dokumenta Aksidenti Ku gjendet Tabela E Aksidenteve Kryesore. Hapi Tjetër Është Tregoni Rreshtin Dhe Kolonën.

Përzgjidh Rreshtin Në Raportin Tuaj

1	Viti
2	Muaj
3	Ditë Jave
4	Ora
5	Rreth
6	Qarku
7	Rruga
8	Ashpra
9	Tipi i Aksidenti
10	Rrethinat
11	Tipi i Siperfaqës
12	Gjeometria e Rrugës
13	Kushtet e Rrugëve
14	Moti
15	Kushtet e Ndrimit
16	Faktorë të tjerë
17	Limiti i Shpejtësisë i Shënuar
18	Lloji i Mjetit
19	Defektet e Automjetit
20	Kërkesat e Automjeteve
21	Mosha e Automjetit
22	Sjellja e Shoferit
23	Patentat

Përzgjidh Kolonën Në Raportin Tuaj

1	Viti
2	Muaj
3	Ditë Jave
4	Ora
5	Rreth
6	Qarku
7	Rruga
8	Ashpra
9	Tipi i Aksidenti
10	Rrethinat
11	Tipi i Siperfaqës
12	Gjeometria e Rrugës
13	Kushtet e Rrugëve
14	Moti
15	Kushtet e Ndrimit
16	Faktorë të tjerë
17	Limiti i Shpejtësisë i Shënuar
18	Lloji i Mjetit
19	Defektet e Automjetit
20	Kërkesat e Automjeteve
21	Mosha e Automjetit
22	Sjellja e Shoferit
23	Patentat

Ecja Raportit

Qalja

Në krye të ekranit ju do të informoheni mbi numrin e goditjeve, aksidenteve që ka prodhuar përzgjedhja e kriterit tuaj. Në shembullin e mësipërm, 20 kritere kanë plotësuar kriterin e përzgjedhur.

Baza e të dhënave përmban 32 ndryshore, të cilat mund të llogariten në mënyrë të ndërthurur kundrejt njëra-tjetrës në një numër të madh përkëmbimesh. Disa prej tyre sigurojnë që nuk kanë lidhje, siç është *Dëshmia e aftësisë për drejtim automjeti* kundrejt *Motit*. Për momentin programi jep shumë pak kufizime mbi përzgjedhjen e rreshtit dhe të kolonës duke qenë se mendohet që është në dorën e përdoruesit përfundimtar të vendosë se çfarë “ka lidhje” dhe çfarë jo.

Nëse keni zgjedhur një ndryshore nga një tabelë e ndryshme nga baza kryesore e të dhënave të aksidenteve, siç është *Tipi i automjetit*, rekordet e të dyja tabelave do të bashkohen me anë të numrit të aksidentit. Kini parasysh që llogaritjet bëhen në varësi të tabelës që shërben si burim të dhënash. Kur bashkohet me tabelën e të dhënave rreth *Automjeteve të përfshira* do të japë numrin e automjeteve, tabelën e *Sjelljes* së drejtuesit të automjetit etj. dhe jo numrin e aksidenteve.

5.3.3 Gjenerimi i raportit

Ecja Raportit

Kur shtypet butoni hapet raporti në *Excel* me emrin *crosstab.xls* i cili është gati për t'u printuar. Kini parasysh që të gjitha raportet ndjekin këtë emër dhe për pasojë mbishkruajnë dosjen ekzistuese *crosstab.xls*. Kështu që, për të mbajtur një raport përgjithmonë, ju duhet ta ruani atë me një emër tjetër. Ruajtja bëhet duke shkuar në menunë *File* dhe përzgjedhur opsionin *Save As*, ku jepet emër i ri.

Ky operacion mund të harxhojë kohë në varësi të shpejtësisë së kompjuterit dhe madhësisë së bazës së të dhënave. Konfirmimi i procedimit të raportit do të shfaqet në një dritare të veçantë:

RAPORTI ËSHTË DUKE U KRIJUAR...

SHËNIM. *Si në të gjitha analizat statistikore duhet të tregohet kujdes me përzgjedhjen e të dhënave dhe zgjedhjen e ndryshoreve për prezantim. Kompjuteri do të paraqesë vetëm numrat prezentë dhe është në dorë të qenies njerëzore që të bëjë një interpretim inteligjent të atyre numrave.*

Raporti do të prezantohet në një tabelë *Excel* që quhet *crosstab.xls*. Nëse keni përzgjedhur vitin 2005 dhe Qarkun e Elbasanit dhe dëshironi të dini numrin e aksidenteve për ashpërsinë sipas ditëve të javës, raporti do të shfaqet si më poshtë:

Viti i fillimit: 2005; Viti i fundit: 2005; Qarku Elbasan

Aksidenti	Ditët e javës							Totali
	E diel	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	
Fatal	9	2	6	3	3	3	7	33
Plagosje minore	4	2	7	1	4	5	5	28
Plagosje serioze	7	1	6	9	5	6	5	39
Totali i përgjithshëm	20	5	19	13	12	14	17	100

Raporti është i thjeshtë por mund t'i shtohen tipare të tjera, si përqindja, kur është në *Excel*. Nëse dëshironi ta ruani raportin përgjithmonë duhet të klikoni në *File_Save As* në *Excel* dhe t'i jepni një emër të ri *crosstab.xls* që të mbishkruhet nga raporti tjetër.

